

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Mikroekonomia II
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative / Departamenti i Ekonomikut Zgjedhore / Departamenti Menaxhment dhe Informatikë
Viti i studimeve:	II-të
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Florentina Xhelili Krasniqi
Detajat kontaktuese:	florentina.xhelili@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me: Analizën e tregut - ndërtimin e modelit dhe statikën krahasuese; Kufizimin buxhetor, taksat dhe subvencionimin; Analizën e preferencave normale dhe preferencave të veçanta dhe ndërtimin e lakoreve të tyre të indiferencës; Analizën e dobisë dhe zgjedhjen optimale për preferencat përkatëse; Analizën e ekuilibrit të tregut: Teknologjinë dhe të ardhurat e shkallës; Maksimizimin e fitimit dhe analizën e kostove të prodhimit.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim zgjerimin dhe thellimin e njohurive të studentëve në fushën e mikroekonomisë; Teorinë e kërkesës së konsumatorit dhe kërkesës së prodhuesve; Efektet e ndryshimeve të çmimit në agjentët ekonomik; Të ardhurat dhe efektet e zëvendësimit në kërkesën dhe ofertën dhe përdorimi i tyre nga qeveria dhe të punësuarit. Tatimet dhe implikimet e tyre në mirëqenie, struktura e tregut dhe efektet në çmime dhe outpute dhe eficienta ekonomike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me kompletimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojnë reagimet e konsumatorit dhe sjelljen e prodhuesve; • të përdorin të ardhurat dhe efektet e zëvendësimit për të analizuar çmimet dhe ndryshimet e tatimeve dhe të ilustrojnë preferencat e konsumatorëve; • të kuptojnë në formë kritike sesi struktura e tregut influencon vendimet për çmimet dhe outputet; • të vlerësojnë faktorët të cilët influencojnë inputet e tregut; • të aplikojnë teorinë ekonomike për çështje dhe probleme praktike ekonomike.
Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata, diskutime, punë në grupe, teste vetëvlerësimi.

Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Kollokviumi i parë: 40% • Kollokviumi i dytë (Pjesë e provimit final)*: 60% <p>*Provimit final në tërësi i nënshtrohen studentët që nuk kanë kaluar pjesën e parë. Të tjerët i nënshtrohen vetëm pjesës së dytë.</p>
------------------------------	---

Literatura

Literatura bazë:

Hal R. Varian, Mikroekonomia, trajtim modern, Onrufi, Tiranë.

Literatura shtesë:

Jefferey M. Perloff: MICROECONOMICS, botimi i katërt.

PLANI I DETAJIZUAR I MËSIMIT PËR NJË SEMESTËR

Java	Krerët	Temat	Literatura bazë/ fq.
Parë		Syllabusi / Hyrje në lëndë	
Dytë	Kreu 1.	Tregu <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi i një modeli ekonomik, optimizimi dhe ekuilibri ▪ Kurba e kërkesës, ofertës, ekuilibri i tregut ▪ Statika krahasuese dhe lloje të tjera të alokimit të apartamenteve ▪ Monopolisti diskriminues, monopolisti i zakonshëm dhe kontrolli i qerasë ▪ Eficenca Pareto dhe ekuilibri në afatë të gjatë 	20-35
Tretë	Kreu 2.	Kufizimi buxhetor <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kufizimi buxhetor dhe tiparet e zonës buxhetore ▪ Si ndryshon vija e buxhetit ▪ Variabli njësi ▪ Taksat, subvencionet dhe racionimi 	36-46
Katërt	Kreu 3.	Preferencat <ul style="list-style-type: none"> ▪ Preferencat e konsumatorit, supozimet rreth tyre dhe kurbat e indiferencës ▪ Preferencat normale ▪ Lloje të ndryshme kurbash indifference dhe norma marxhinale e zëvendësimit ▪ Interpretimet e MRS dhe sjellja e saj 	47-62
Pestë	Kreu 4.	Dobia <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi i një funksioni dobie, shembuj dhe dobia kardinale ▪ Lloje të ndryshme kurbash indifference (Cobb-Douglas etj) dhe dobia e tyre ▪ Dobia marxhinale dhe MRS 	63-78

Gjashtë	Kreu 5.	Zgjedhja <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa e konsumatorit dhe zgjedhja optimale. ▪ Shembuj zëvendësuesit e plotë, bashkëplotësuesit e plotë, të mirat asnjëse, dhe mallra të padëshiruara, të mirat në njësi të pandashme. ▪ Preferencat konkave, Cobb-Douglas dhe vlerësimi i funksioneve të dobisë ▪ Rrjedhimet e kushtit të MRS dhe zgjedhja e taksave. 	79-96
Shtatë	Kollokviumi i parë		
Tetë	Kreu 6.	Kërkesa <ul style="list-style-type: none"> ▪ Te mirat normale dhe inferiore. ▪ Kurba e te ardhurave të ofruara dhe kurba e Engellit, shembuj të ndryshëm. ▪ Të mirat e zakonshme dhe të mirat Giffen ▪ Kurba e çmimeve të ofruara dhe kurba e kërkeses, shembuj të ndryshëm. ▪ Kurba e anasjelltë e kërkesës. 	97-114
Nëntë	Kreu 16.	Ekulibri <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ekulibri i tregut dhe kurbat e anasjellta të kërkesës dhe ofertës ▪ Statikë krahasuese, zhvendosjet e kurbave ▪ Taksat, kalimi i një takse të tjerëve dhe humbja neto nga një taksë ▪ Eficienca Pareto 	243-259
Dhjetë	Kreu 17.	Teknologjia <ul style="list-style-type: none"> ▪ Funksioni i prodhimit në periudhë afatshkurtër ▪ Funksioi i prodhimit në periudhë afatgjatë: shembuj të ndryshëm të teknologjisë ▪ Të ardhurat e shkallës 	260-278
Njëmbëdhjetë	Kreu 18.	Maksimizimi i fitimit <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fitimet dhe vlera e tregut të kapitalit aksionar ▪ Faktorët e pandryshueshëm dhe faktorët e ndryshueshëm të prodhimit ▪ Maksimizimi i fitimit në periudhë afatshkurtër ▪ Maksimizimi i fitimit në periudhë afatgjatë ▪ Maksimizimi i fitimit dhe të ardhurat e shkallës 	270-283
Dymbëdhjetë	Kreu 19.	Minimizimi i kostos <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të ardhurat e shkallës dhe funksioni i kostos ▪ Kostot afatgjata dhe afatshkurtra ▪ Kostot e pandryshueshme dhe kostot pothuajse të pandryshueshme 	284-294
Trembëdhjetë	Kreu 20.	Kurbat e kostos <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kostot mesatare ▪ Kostot marxhinale dhe kostot e ndryshueshme ▪ Kostot afatgjata ▪ Kostot marxhinale afatgjata 	294-304
Katëmbëdhjetë	Kreu 27.	Teoria e lojës	

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Matrica e rezultateve të lojës dhe Ekuilibri Nash ▪ Strategji të përziera, Dilema e të burgosurit ▪ Lojëra të përsëritura ▪ Vendosija e një karteli ▪ Lojërat me veprime pasuese dhe Lojë me pengimin e hyrjes 	392-401
Pesëmbëdhjetë	Test vetëvleresimi		